

RaiMagazine

Çka ka të re në bankën më të madhe në Kosovë?

Gjithçka që duhet të dini:

Oferta jonë digjitale

Intervistë:

Synimi është të ndërtojmë një bankë digjitale me ndërveprim njerëzor

Të rejat e fundit:

Banka më e mirë në çmimet e "Euromoney"

Njihuni me RaiMagazine

Të nderuar lexues,



Kemi kënaqësinë t'juja prezantojmë edicionin e parë të RaiMagazine. Edhe pse ne vazhdimisht angazhohemi për të qenë transparentë dhe për të siguruar komunikim të shëndetshëm me klientët dhe partnerët tanë përmes kanaleve të ndryshme, ky buletin paraqet edhe një platformë tjetër shtesë komunikimi.

Në botën plot me dinamizëm në të cilën po jetojmë, ka shumë mundësi që t'ju ikin disa nga storjet tona. Kjo është arsyeja pse duam të sjellim para jush ngjarjet më të reja dhe më të rëndësishme lidhur me bankën tonë, shërbimet, produktet dhe zhvillimet e ndryshme - të gjitha në një vend.

Përveç kësaj, synojmë ta përdorim këtë buletin për të ndarë me

ju analiza, intervista dhe fakte interesante rreth temave të ndryshme që ndërlidhen me punën e bankës por edhe të sektorit bankar e financiar në përgjithësi. Në këtë kontekst, dëshirojmë të shprehim mirënjohjen për partnerët të cilët kontribuuan për këtë edicion inaugurues.

Derisa shënojmë 20-vjetorin e të bërit biznes në Kosovë, ne vazhdimisht jemi në kërkim të mënyrave për të përmirësuar proceset tona, duke zhvilluar shërbime dhe produkte të reja për të siguruar përvoja superiore të klientit. Në këtë drejtim, besojmë se komunikimi efektiv e avancojmë edhe më tej ofertën tonë.

Në fund, na lejoni të ju falënderojmë që jeni klient dhe partner besnik i Bankës Raiffeisen në Kosovë!

Nektar Zogjani,
Redaktor Përgjegjës i RaiMagazine

- 02 Njihuni me RaiMagazine
- 04 Rrugëtimi ynë 20-vjeçar në Kosovë
- 06 Gjithçka që duhet të dini për ofertën tonë digjitale
- 08 Banka më e mirë në Kosovë në çmimet e Euromoney



Mbështesim kinematografinë e Kosovës përmes PriFest

- 09 Mbështetje për pesë ndërmarrje drejt tranzicionit "të gjelbër" të tyre
- 10 Dita e Krenarisë: Promovimi i diversitetit përmes diskutimit online
- 10 Mbështesim kinematografinë e Kosovës përmes PriFest



Zvogëlimi i gjurmës së karbonit përmes praktikave tona eko-miqësore

- 12 Modelet e rritjes së BPV-së: Sektori i ndërtimitarisë tregon rimëkëmbje
- 14 ESG-ja: Përkushtimi ynë për bankim të përgjegjshëm
- 16 Financat e qëndrueshme: Kombinimi i biznesit me një kauzë të mirë



Krijimi i një kulture të suksesshme në vendin e punës

- 18 RaiEco: Kredia e gjelbër për transformimin e shtëpisë tuaj
- 20 Toçi: Synimi ynë është të ndërtojmë një bankë digjitale me prekje njerëzore
- 22 Zvogëlimi i gjurmës së karbonit përmes praktikave tona eko-miqësore
- 23 Galeria Raiffeisen: Promovimi i artit lokal që nga viti 2016
- 24 Krijimi i një kulture të suksesshme në vendin e punës

Rrugëtimi ynë 20-vjeçar në Kosovë

Banka Raiffeisen këtë vit feston 20-vjetorin e saj në Kosovë. Banka mori emrin Raiffeisen në qershor të vitit 2003 pasi Raiffeisen Bank International (RBI) bleu aksionet të atëbotë Bankës Amerikane të Kosovës. Teksa banka operonte në kontekstin e një ekonomie në rindërtim në atë kohë, Raiffeisen është aktualisht banka më e madhe në Kosovë në të gjithë treguesit e rëndësishëm financiare, me asete totale prej 1.3 miliardë euro në qershor 2023.

Për ta përmbledhur këtë rrugëtim të jashtëzakonshëm, ne kemi prezantuar një slogan të thjeshtë: Mbështetje. Përgjegjësi. Inovacion. Shumë më tepër se sa vetëm një slogan, këto deklaratat kanë përfaqësuar parimet udhëzuese të punës sonë.

Përgjatë këtyre dy dekadave, jemi përpjekur të ofrojmë shërbime financiare me cilësi të lartë për individët dhe bizneset, duke mbështetur planet dhe idetë e tyre, e në këmbim duke mundësuar rritje të qëndrueshme në vend. Përgjegjësia ka qenë thelbi i operacioneve tona. Kemi përqaftuar vlerat e bankimit të përgjegjshëm, duke garantuar se kemi prioritet mirëqenien e klientëve, partnerëve, punonjësve tanë dhe komunitetit në përgjithësi. Dhe natyrisht, inovacioni ka qenë shtyllë themelore e strategjisë sonë. Duke zhvilluar dhe prezantuar shumë zgjidhje dhe produkte digjitale, e kemi përmirësuar vazhdimisht përvojën bankare të klientëve tanë.

"Raiffeisen është shembull shumë i mirë i investimeve të huaja austriake në Kosovë. Jemi krenarë që kemi kontribuar dhe jemi pjesë e sistemit të suksesshëm bankar në Kosovë," thotë Drejtoresha Ekzekutive, znj. Anita Kovacic.

"Suksesi ynë është arritur duke ofruar produkte dhe shërbime të qëndrueshme bankare, me besimin e klientëve tanë, angazhimin e punonjësve tanë si dhe bashkëpunimin profesional me rregullatorë dhe institucione si dhe partnerë tjerë të komunitetit. Në emër të Raiffeisen-it dua t'i falënderoj të gjithë ata që kanë e kanë zgjedhur Raiffeisen si bankën ose partnerin e tyre afarist," shton zonja Kovacic.

Marrë parasysh kontekstin në të cilin banka Raiffeisen hyri në tregun e Kosovës në vitin 2003, mund të thuhet me siguri se banka ka pasur rrugëtim të veçantë të rritjes së bashku me klientët, partnerët dhe punonjësit. Dhe banka do të vazhdojë të llogarisë në të gjithë ata, teksa shikon drejt një të ardhmeje të ndritur!



Deri në qershor 2023



36
degë



Rreth
130
bankomatë



Mbi
900
punonjës



Mbi
300.000
klientë

20.1%
të totalit të aseteve
bankare në treg

20.6%
të totalit të
depozitave

19.9%
të totalit të
kredive

Gjithçka që duhet të dini për ofertën tonë digjitale

Banka Raiffeisen në Kosovë operon me rrjetin më të madh të degëve në vend, si dhe po bëhen përpjekje të vazhdueshme për ta përmirësuar edhe më tej ofertën digjitale.

Siç u shpreh Udhëheqësi i Departamentit për Individë, Klientë Premium dhe Rrjetin e Degëve, Erik Roka, gjatë intervistës së fundit në transmetuesin publik të Kosovës, produktet dhe shërbimet digjitale janë të sigurta për t'u përdorur dhe ofrojnë një përvojë të shkëlqyer bankare.



[Për më shumë kliko këtu](#)

RaiKesh

Kjo platformë interneti është krijuar për ta bërë aplikimin për kredi të lehtë, të shpejtë dhe përmes internetit. Krejt çka u nevojiten janë dy dokumente, lidhja e internetit dhe brenda pak minutash e pranoni ofertën dhe miratimin.



[Për më shumë kliko këtu](#)

Lajmi i mirë është se përdorimi i këtyre produkteve është rritur gjatë viteve të fundit, ndërkohë që përditësimi i fundit i sistemit tonë bankar kryesor do t'i mundësojë bankës të përmirësojë edhe më tej platformat e veta digjitale.

Na lejoni t'juja prezantojmë një pjesë të portfolios sonë digjitale:

RaiPay

Me pak fjalë, RaiPay është kuleta juaj – vetëm se është tërësisht digjitale. Kjo nënkupton se mund të bëni pagesa pa pasur nevojë ta mbani me vete kartelën Visa ose Mastercard.

Shkarkoni aplikacionin në celularin tuaj, digjitalizoni kartën tuaj dhe mos e humbisni këtë përvojë praktike dhe të sigurt bankare!



[Për më shumë kliko këtu](#)

RaiPos

Me këtë aplikacion inovativ, mund ta shndërroni telefonin tuaj celular në POS dhe të pranoni pagesa pa kontakt me kartelë Visa dhe Mastercard.

Aplikacioni ofron përparësi sepse e merrni POS-in tuaj kudo që keni nevojë, pa pasur nevojë të përballeni me problemet me kablllo ose pajisje shtesë. Është i lehtë për tu përdorur dhe shumë i sigurt për pranimin e pagesave. Kontrolllo QR për të parë se si mund të aplikoni për ta marrë të njëjtin!

Raiffeisen Plus


Raiffeisen Plus është platforma jonë kryesore digjitale. Mund ta përdorni nga telefoni celular ose kompjuteri juaj, e kjo platformë i ka të gjitha: bilancin tuaj të kreditit, kreditë, pagesat dhe shumëçka tjetër. Është miqësore për përdorues si për individë ashtu edhe për biznese.



[Për më shumë kliko këtu](#)



[Për më shumë kliko këtu](#)



STICK n PAY

STICK 'N' PAY - RBKO (raiffeisen-kosovo.com)

Një letër ngjitëse [sticker] e thjeshtë që vendoset në telefonin ose çfarëdo pajisje tjetër tuaj që ju mundëson të bëni pagesa. Vizitoni degën tuaj më të afërt dhe merrni letrën ngjitëse dhe validimin për të.

Përditësimi i sistemit bankar kryesor:

"E ardhme premtuese për ofertën tonë digjitale"

Në qershor, Departamenti ynë i IT-së arriti një moment kulmor të rëndësishëm duke e migruar me sukses sistemin tonë bankar kryesor në një version më të ri dhe më të sofistikuar.

Ky version më i ri tani është përditësuar dhe krijon përparësi të madhe për ne në treg, duke ofruar veçori të avancuara teknologjike dhe do të shërbejë si bazë e fortë për zgjidhjet inovative digjitale. Udhëheqësi i këtij departamenti, Shkëlqim Meqa, beson se "ndikimi i këtij zhvillimi në operacionet tona do të jetë transformues".



Shkëlqim Meqa

"Migrimi i të dhënave të CBS shënon një të ardhme premtuese edhe për ofertat tona digjitale. Veçoritë e avancuara teknologjike të versionit [Release] 19 do të shërbejnë si bazë e fortë për zgjidhjet inovative digjitale. Ndërkohë që banka vazhdon të evoluojë, po ashtu do të zhvillohet edhe kapaciteti ynë për të zhvilluar platforma të sofistikuar bankare digjitale që plotësojnë nevojat e klientëve tanë, të cilat janë gjithnjë në ndryshim", tha Meqa.

Banka më e mirë në Kosovë në çmimet e Euromoney

Në tetor, banka jonë është vlerësuar me tri çmime në #EuromoneyAwards for Excellence 2023. Përkushtimi dhe arritjet e bankës në vitin 2022 u vlerësuan në tri kategori të rëndësishme: Banka më e mirë për korporata, Banka më e mirë për zgjidhje digjitale, dhe Banka më e mirë për ESG.

Këto çmime prestigjioze ndahen nga viti 1992 dhe bazohen në disa kritere rigorozë të vlerësimit. Ato jo vetëm që demonstrojnë përkushtimin tonë për të ofruar një përvojë superiore bankare për klientët

tanë, por gjithashtu shfaqin përkushtimin tonë të palëkundur ndaj qëndrueshmërisë përmes Agjendës sonë #ESG (Mjedisore, Sociale dhe Qeverisje). Në korrik të këtij viti, Banka u vlerësuar edhe si Banka më e Mirë në Kosovë nga këto çmime.

Përgjatë dy dekadave të operimit në Kosovë, ne jemi nderuar me çmime të shumta dhe përkushtimi ynë për përsosmëri mbetet i palëkundur ndërsa shikojmë drejt së ardhmes.



Mbështetje për pesë ndërmarrje drejt tranzicionit "të gjelbër" të tyre

Kohëve të fundit i jemi bashkuar projektit BOOST të Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë për të mbështetur pesë ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) drejt tranzicionit "të gjelbër" të tyre.

Bashkëpunimi mes bankës dhe UNDP-së në Kosovë vjen pasi palët nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi, që i mundësoi bankës të ofrojë mbështetje financiare për pesë

ndërmarrje përfituese. Konkreisht, banka ka ndarë 3,000 euro secilës kompani të përzgjedhur për mbështetje nga programi BOOST si palë zbatuese.

Mbështetja e nismave që promovojnë agjendën e gjelbër është pjesë kyçe e strategjisë ESG të bankës sonë. Ne do t'ju informojmë edhe më tutje për progresin e arritur nga kompanitë përfituese!



**Diversity is
part of our
bank culture!**

Dita e Krenarisë: Promovimi i diversitetit përmes diskutimit online

Banka Raiffeisen në Kosovë promovon një kulturë e cila kultivon diversitetin, barazinë dhe përfshirjen. Në qershor, si pjesë e diskutimeve tona mbi diversitetin që filluan në fillim të vitit, organizuam diskutim online të fokusuar veçanërisht në të drejtat e komunitetit LGBTQ+ në Kosovë.

Në këtë aktivitet morën pjesë rreth 180 punonjës të bankës

sonë, ku morën pjesë edhe folës nga banka jonë, kolegët tanë nga RBI dhe përfaqësuesi i CEL Kosova- organizatë që promovon të drejtat e komuniteteve në Kosovë.

Banka jonë po bën përpjekje të vazhdueshme në përmirësimin e mjedisit të punës brenda organizatës sonë duke siguruar që të drejtat e secilit të respektohen dhe çmohen plotësisht.



Mbështesim kinematografikë e Kosovës përmes PriFest

Banka Raiffeisen në Kosovë vazhdoi mbështetjen e saj për PriFest - Prishtina International Film Festival, një ngjarje e rëndësishme kulturore që shënoi edicionin e 15-të këtë vit.

Ceremonia e hapjes, e cila mbledhi në Prishtinë producentë dhe adhurues filmash nga vende të ndryshme, u pasua nga premiera e filmit "The Land Within" [Toka brenda meje], që shënoi zyrtarisht nisjen e festivalit. Banka Raiffeisen e ka mbështetur PriFest që nga dita e parë. Gjatë ceremonisë së hapjes, CEO Anita Kovaçiq tha se banka është partnere e

festivalit për disa arsye

"Ne e mbështesim festivalin jo vetëm për faktin se na pëlqen të shohim ndonjë film të mirë," tha zonja Kovacic, duke shtuar se festivali kontribuon në ndërkombëtarizimin e kinematografisë kosovare " e cila ka shumë për të thënë për një vend që ka kaluar nëpër tranzicion të jashtëzakonshëm politik, historik dhe shoqëror në dekadat e fundit".

Banka Raiffeisen në Kosovë SHTËPI E BIZNESEVE



Pavarësisht nëse jeni korporatë apo biznes i vogël, banka ka një ofertë të shkëlqyer për t'ju ndihmuar që të rriteni!

Modelet e rritjes së BPV-së: Sektori i ndërtimitarisë tregon rimëkëmbje



Fjorent Rrushi
Kryesues i ALM & Research, Banka Raiffeisen në Shqipëri



Valbona GJEKA
Zyrtare e Lartë për Hulumtim, Banka Raiffeisen në Shqipëri

Ekonomia e Kosovës mori një **kthesë të papritur** në TM2 të vitit 2023, me rritjen e BPV-së që ra në 2.0% në terma vjetorë. Inflacioni pa një ndryshim të papritur “rollercoaster ride”, nga rënia në presione të reja. Paqëndrueshmëria politike dhe **marrëdhëniet me Serbinë** e shtojnë kompleksitetin. **Parashikimi ynë i BPV** për vitin 2023 është në **shqyrtim**. Rrini të kyçur ndërsa gërmojmë më thellë në këto tregime ekonomike të shpalosura, duke analizuar sfidat dhe perspektivat që përcaktojnë rrugëtimin ekonomik të Kosovës në vitin 2023.

Rritje e ngadaltë mes shenjave shqetësuese

Bazuar në të dhënat më të fundit, ekonomia e Kosovës ka shënuar një zgjerim të **kufizuar** në TM2 të vitit 2023. Gjatë TM2 të vitit 2023, ekonomia vendase u rrit me **vetëm 2.0%**, dukshëm më e ulët se norma jonë e parashikuar e rritjes dhe parashikimet e subjekteve të tjera vendore.

Kjo rënie e normës së rritjes u vërtetua nga statistikat e shërbimit afatshkurtër për muajin qershor, të publikuara dy ditë përpara raportit tremujor të rritjes së BPV. Këto statistika zbuluan se **indeksi i qarkullimit për shërbime ishte zhvendosur në territor negativ** në qershor, pas një rritjeje të konsiderueshme prej 39% nga viti në vit e vërejtur në prill.

Performanca sektoriale: Sfidat dhe shenjat e rimëkëmbjes në TM2 të vitit 2023

Për sa i përket sektorëve të veçantë, sektori “tregtia, transporti dhe akomodimi” që mbart

peshën më të rëndësishme në strukturën e BPV, shfaqti një normë rritjeje prej **vetëm 2.4%** nga viti në vit, në kontrast të plotë **me rritjen prej 12.6% nga viti në vit** të regjistruar në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Përveç kësaj, sektorët e tjerë të shërbimeve, si TI, pasuritë e paluajtshme dhe shërbimet financiare panë gjithashtu norma të ulëta rritjeje përkatësisht **2.0%, 2.2% dhe 3.6% nga viti në vit**. Nga ana tjetër, sektorët si aktivitetet profesionale si dhe aktivitetet e kohës së lirë, shënuan ritme pak më të larta rritjeje, përkatësisht **5.1% dhe 5.8%**. Megjithatë, kontributi i tyre në rritjen e përgjithshme mbeti relativisht i kufizuar për shkak të bazës së tyre më të vogël. Veçanërisht, sektori i administratës publike, i cili renditet si i dyti më i madh në mesin e shërbimeve, u tkurr me 0.8% nga viti në vit.

Sektori i prodhimit hasi pjesën e tij të vështirësive, veçanërisht pasi **industria e përgjithshme pa një rënie prej 2.0%** rritje nga viti në vit në TM2 të vitit 2023. Megjithëse prodhimi arriti të zgjerohej, ai e bëri këtë me një ritëm të reduktuar, duke regjistruar një rritje prej **3.4% nga viti në vit, një ngadalësim nga rritja prej 7.8%** e vërejtur një vit më parë. Për dallim, industria nxjerrëse mbeti në një gjendje tkurje për shkak të çmimeve të ulëta të mineraleve dhe kërkesës së ngadaltë. Anasjelltas, sektori i ndërtimitarisë tregoi shenja përmirësimi me një normë rritjeje prej vetëm **2.7%**, e cila mund të shihet si një rimëkëmbje e dukshme kur merret në konsideratë **rënia** e mprehtë e sektorit prej **10.7% nga viti në vit** në TM2 të vitit 2022. Kjo zhvendosje pozitive theksohet më tej nga indeksi i kostonë së ndërtimit, i cili tregon një barrë kostoje

dukshëm më të lehtë për sektorin, me vetëm një rritje prej **1%** nga viti në vit krahasuar **me rritjen e konsiderueshme prej 19.8%** të parë në TM2 të vitit 2022. Ndërkohë, bujqësia vazhdoi të rritet, ndonëse me një normë modeste prej 2.8%, duke mbetur nën potencialin e saj të plotë.

Zvarritja e eksporteve neto, elasticiteti i konsumit dhe rikthimi i investimeve

Gjatë ekzaminimit të komponentëve të BPV duke përdorur qasjen e shpenzimeve, u shfaqën zhvillime të rëndësishme. Eksportet e shërbimeve **u rritën me 13.6%** nga viti në vit, duke shfaqur rritje të fuqishme. Megjithatë, efekti i kundërt ka pasur edhe eksporti i mallrave, duke u **ulur me 10.7%** nga viti në vit. Rrjedhimisht, zgjerimi i përgjithshëm i eksporteve të mallrave dhe shërbimeve qëndroi në vetëm **5.9% nga viti në vit, një rënie e ndjeshme nga rritja e jashtëzakonshme prej 36.0%** nga viti në vit e dëshmuar një vit më parë kur çmimet e eksporteve u rritën.

Nga ana tjetër, importet e mallrave dhe shërbimeve vijuan trajektoren e tyre rritëse, duke u rritur me 6.3% nga viti në vit. Kjo çoi në një **deficit tregtar të konsiderueshëm**, duke kontribuar negativisht në rritjen ekonomike nëpërmjet eksporteve neto. Konsumi i ekonomive familjare luajti një rol kryesor në nxitjen e rritjes, **duke u rritur me 3.7%** nga viti në vit, duke tejkaluar normën e rritjes prej **2.0%** nga viti në vit. Rritja e konsumit të ekonomive familjare u nxit kryesisht nga një rritje prej **14% nga viti në vit në remitancat nga diaspora** gjatë TM2 të vitit 2023, krahas një rritjeje prej **16.8% nga viti në vit në kreditë për ekonomitë familjare** gjatë së njëjtës periudhë.

Konsumi i qeverisë gjithashtu u rrit me 4.0% nga viti në vit, ndërsa formimi i kapitalit bruto u rrit me 2.0% nga viti në vit. Ky i fundit u rikuperua ndjeshëm nga **tkurrja prej 12.4%** e vërejtur në vitin e kaluar, pasi si sektori privat ashtu edhe ai publik shfaqën një gatishmëri më të madhe për të investuar në një mjedis më të qëndrueshëm të karakterizuar nga norma inflacioni në rënie.

Dinamika e inflacionit: Një ndryshim i papritur me presione në rritje

Normat e inflacionit pësuan një ulje të ndjeshme, duke rënë nga një mesatare vjetore prej **9.9%** në TM1 të vitit 2023 në një mesatare prej **4.2% vjetore në TM2 të vitit 2023**. Kjo rënie ishte veçanërisht e dukshme në sektorë të veçantë, veçanërisht në çmimet e ushqimeve dhe transportit, të cilat lidhen me rënien trend në tregjet ndërkombëtare.

Megjithatë, ka pasur një rritje të lehtë të inflacionit në muajin gusht, duke regjistruar një normë vjetore prej 3.2% dhe **një rritje mujore 1.0%**, duke sinjalizuar shfaqjen e presioneve të reja inflacioniste. Si inflacioni bazë ashtu edhe inflacioni total pësuan një rritje, **duke arritur në 4.0% në gusht nga 3.2% në muajin korrik të vitit 2023**, duke treguar se inflacioni me bazë të gjerë ka të ngjarë të vazhdojë për një periudhë të gjatë.

Faktorë të tillë si luhatjet e çmimeve të energjisë në tregun global, zbatimi i ligjit të ri që rregullon pagat publike dhe kushtet e shtrënguara të tregut të punës mund të sjellin presione të tjera inflacioniste në muajt në vijim.

Rreziqet negative për rritjen e BPV-së në vitin 2023

Si përfundim, performanca e **dobët** ekonomike në TM2 të vitit 2023 na ka shtyrë të mendojmë për një rishikim të **parashikimeve tona** të rritjes së **BPV-së** për të gjithë vitin. Mungesa e stabilitetit politik në veri të Kosovës, së bashku **me mungesën e një zgjidhjeje përfundimtare me Serbinë, paraqet pengesa të konsiderueshme** për perspektivat ekonomike të Kosovës. Për të nxitur përmirësimin afatgjatë ekonomik, është e domosdoshme t'i jepet përparësi përpjekjeve drejt normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë, zbatimit të reformave thelbësore strukturore dhe vendosjes së masave të qëndrueshmërisë brenda sektorit të energjisë. Rrjedhimisht, ne jemi duke **rishikuar** parashikimin tonë të BPV-së për vitin 2023, **duke pasur në mendje një rregullim të mundshëm në rënie**.

ESG-ja: Përkushtimi ynë për bankim të përgjegjshëm

Duke qenë banka më e madhe në vend, Raiffeisen synon të luajë rolin e saj në promovimin e bankimit të përgjegjshëm dhe financave të qëndrueshme përmes agjendës së saj të ESG.

Dy ditë përplot diskutime të frytshme të fokusuar kryesisht në promovimin e qëndrueshmërisë, ndryshimet klimatike dhe mobilizimin e burimeve për të mbështetur iniciativat e gjelbra u mbajtën më 15-16 qershor në Prishtinë, si pjesë e samitit të ESG të Raiffeisen në Kosovë – ngjarja më e madhe kjo në vend në këtë fushë.

E organizuar për të shënuar 20-vjetorin e operimit në Kosovë, ngjarja ishte një mundësi për të shfaqur përkushtimin e bankës në këshillimin dhe mbështetjen e klientëve dhe partnerëve të saj drejt tranzicionit në ekonominë e gjelbër. Qellim tjetër i rëndësishëm

i samitit ishte të kontribuoj në promovimin e temave të agjendës së gjelbër në Kosovë.

Përfaqësuesit nga sektori publik dhe privat si dhe ata nga organizatat e shoqërisë civile që morën pjesë në diskutimet në samit u pajtuan njëzëri se meqë ndryshimet klimatike na prekin të gjithëve, tani nevojitet veprim i përbashkët për të ecur drejt një të ardhmeje më të qëndrueshme.

Ata mirëpritën çdo nismë që vjen nga bankat, institucionet publike dhe individët në këtë drejtim.



Antigona Limani-Bejtullahu,
Udhëheqëse e Departamentit për
Qëndrueshmëri dhe Komunikim

“Siç thuhet, ndryshimi duhet të fillojë nga vetvetja. Prandaj, si bankë, i shqyrtojmë vazhdimisht mundësitë për të siguruar që aktiviteti ynë bankar të ketë ndikim pozitiv në shoqëri. Pasi që jemi banka më e madhe në vend, mendojmë se duhet të japim shembull që tjerët ta ndjekin.”



Agjenda ESG [mjedisore, sociale dhe e qeverisjes]

Përpjekjet e bankës në fushën e ESG-së përqendrohen në katër shtylla kryesore: Biznesi Themelor, Punonjësit, Investime në Komunitet dhe Ekologjia e Brendshme (in-house).

Qëndrueshmëria në biznesin Investimi në komunitet themelor

Raiffeisen Bank embraces the role as a “responsible banker” with a primary objective of creating long-term added value. Sustainability is deeply ingrained in our business strategy, and we align our products, services, and processes accordingly. Our holistic approach revolves around minimizing ESG risks and seizing opportunities to enhance environmental protection and social standards

Punonjësit

Banka është e përkushtuar të investojë në njerëzit e vet, duke iu ofruar mundësi për t’i përsosur aftësitë e tyre përmes një sërë platformash të mësimi dhe zhvillimit. Për shembull, sistemi rishtazi i përditësuar për menaxhimin e mësimi (LMS) në internet ofron shërbime me cilësi të lartë dhe përvojë moderne të mësimi duke përdorur teknologjinë më të fundit. Banka jonë ndanë përkushtimin e RBI Group për mundësi të barabarta për të gjithë punonjësit, pavarësisht moshës, gjinisë, kombësisë, orientimit seksual dhe identitetit, aftësisë së kufizuar, fesë apo besimit.

Si pjesë e strategjisë së saj të qëndrueshmërisë dhe ESG, banka Raiffeisen në Kosovë ka qenë shumë aktive si një “qytetar i angazhuar” dhe ka investuar në aktivitete brenda komunitetit. Mbështetja e bankës për komunitetin ka qenë e dyfishtë, përmes mbështetjes së drejtpërdrejtë të projekteve të ndryshme dhe nëpërmjet bashkëpunimit me organizata dhe institucione të ndryshme që veprojnë në Kosovë. Thirrja për të ofruar sponsorizime për vitin 2024 ka cekur katër fusha kryesore të mbështetjes: sportin, mjedisin, arsimin dhe kulturën.

Ekologjia e brendshme(in-house)

Ne e konsiderojmë mbrojtjen e mjedisit dhe klimës si pjesë të përgjegjësisë sonë ndaj shoqërisë dhe e shohim veten si partner të drejtë ndaj mjedisit. Ndikimet e drejtpërdrejta mjedisore të aktiviteteve tona operative janë të kufizuara në krahasim me ato të industrive prodhuese. Sidoqoftë, si bankë synojmë kufizimin e ndikimeve negative mjedisore në të gjitha mjediset e veta. Prandaj, punojmë vazhdimisht për të përmirësuar parametrat kryesorë mjedisorë në fushat më të rëndësishme.

Financat e qëndrueshme: Kombinimi i biznesit me një kauzë të mirë

Markus Ecker, Udhëheqës i Financimit të Qëndrueshëm në RBI, shpjegon pse të gjithë po "luajnë mendsh" pas financave të qëndrueshme dhe pse RBI është përpara në garë sa i përket kësaj teme.



Redaktori:
Martin Schreiber
(RBI)

Markus, thatë gjatë diskutimit paraprak të kësaj interviste se të gjithë po "luajnë mendsh" pas financave të qëndrueshme për momentin. Pse është kështu?

Sepse i kombinon aspektet e biznesit me një kauzë të mirë. Në thelb, është shumë tërheqëse për secilin prej nesh në bankë, por edhe për gjithë klientët dhe investitorët tanë, nëse mund të arrihet efekt pozitiv për mjedisin apo shoqërinë nëpërmjet biznesit. Një pjesë e përkufizimit të financave të qëndrueshme është krijimi i financimit për qëllim të qëndrueshëm. Ndërtimi i parkut me erë për shembull ose në veçanti, i ndërtesës me efizienz energjetike. Pjesa tjetër e spektrit të produkteve tona janë produktet që ndikojnë në sjelljen e klientit në lidhje me qëndrueshmërinë, për shembull duke lidhur madhësinë e marzhës me arritjen e caktuar të qëndrueshmërisë nga klienti.

Me fjalë tjera, banka është kuazi- edukative dhe paraqet zgjidhje se si klienti mund të përmirësohet në aspektin e qëndrueshmërisë.

Po, saktë, kjo është një pjesë thelbësore e konsultimit tonë, për t'i shpjeguar së pari klientit se çfarë nënkupton praktika më e mirë, ku mund të ketë ai mangësi në krahasim me të dhe çfarë mund ose duhet të bëjë për të qenë në përputhje me pritshmëritë e tregut. Bankat e bëjnë këtë për disa motive. Së pari, sepse është e mirë për biznesin. Jo vetëm në kuptimin e lidhjes së udhës, por edhe për marrëdhënien afatgjatë me klientin. Ne besojmë se klienti që shqetësohet për aspektet mjedisore dhe sociale, si dhe të

qëndrueshmërisë është edhe ekonomikisht i qëndrueshëm dhe si rezultat paraqet risk më të mirë për bankën. Aspekti i dytë është roli që na ka dhënë politika në nivel evropian. Komisioni Evropian ka investuar shumë energji për të caktuar se çfarë është transaksioni i qëndrueshëm. Kjo është e ashtuquajtura taksonomia e BE-së. Njëkohësisht, janë përcaktuar metrikat sa i përket proporcionit të asetëve të qëndrueshme në portfolion e bankës. Pra, nuk e bëjmë këtë thjesht për përfitimin tonë, por po ndihmojmë për të arritur caqet në nivel të Evropës dhe për të përmbushur kërkesat e rregullatorit.

Me fjalë tjera, situatë me përfitim në të gjitha aspektet (win-win-win) ku (duhet të) marrin pjesë gjitha bankat. Çfarë përparësie të veçantë sa i përket këshillave dhe produkteve mund t'u ofrojë RBI klientëve të saj?

Ashtu është, të gjithë e bëjnë. Përparësia jonë është se jemi në gjendje të këshillojmë klientin më mirë se të tjerët, veçanërisht në Evropën Lindore ose në vendet jo anëtare të BE-së. Kemi një pikë të veçantë shitjeje këtu, sepse e njohim mjedisin lokal dhe kushtet e tregut më mirë se të tjerët. Dhe ndoshta edhe sepse ne ngrisim çështjen në mënyrë proaktive. U takuam me një klient në Rumani, një kompani riciklimi, drejtori ekzekutiv i së cilës ka marrë pjesë në secilin panel diskutimi në vend ku flitej mbi qëndrueshmërinë, sepse personalisht është i interesuar për këtë temë. Dhe ne ishim banka e parë që folëm seriozisht me të rreth qëndrueshmërisë. Pa dyshim se kjo ishte me dobi për pozitën tonë.

Në përgjithësi, a janë klientët tanë tashmë të akomoduar mirë rreth temës së qëndrueshmërisë apo janë ende në fillim të rrugëtimit të tyre?

Të dyja, edhe pse fokusi është gjithnjë e më shumë tek klientët që duan të hyjnë në detaje. Kjo në të vërtetë është edhe pika jonë e fortë; na duhet të përcjellim njohuritë themelore vetëm të shumë pak klientë. Dy-tre vjet më parë, kjo ende paraqiste problem ndonjëherë, por sot diskutimet me ekspertët tanë tashmë janë shumë të fokusuara në nevojat specifike dhe të përcaktuara të kompanisë përkatëse.

Dhe çka e bën një kredi "të qëndrueshme"?

Nëse kredia përdoret për projekte miqësore me klimën ose projekte sociale, ose nëse banka e ndërlikohet madhësinë e marzhës së kredisë me sjelljen e klientit në lidhje me qëndrueshmërinë, për shembull, ose me përmirësimin në vlerësimin e tij të qëndrueshmërisë. Me fjalë tjera, marzha zvogëlohet nëse tejkalohe treguesit e paracaktuar kryesorë të performancës (KPI). Sfidat me këtë produkt është se gjithmonë duhet të përcaktoni KPI-në që i përshtatet specifikave të klientit. Kjo është pjesë e këshillimit tonë dhe mund të ketë mos dakordime, por zakonisht i zgjidhim ato. Përpiqemi të pajtohemi për KPI realiste me pika fillestare dhe fundore të verifikueshme. Fundja, ajo çka ka rëndësi për klientin nuk janë disa pikë bazë plus ose minus – kjo vërtet nuk bën ndonjë dallim – por që ai të lëvizë në drejtimin e dëshiruar.

E përmendët ekspertizën tonë në rajonin e EQL në fillim. Çfarë bëni për ta ruajtur apo zgjeruar këtë ekspertizë dhe pozitën tonë në rajon?

Si pjesë e Qendrës së Kompetencës të ESG, kemi formuar shumë herët rrjetin e ambasadorëve të ESG në bankat e rrjetit. Sot, ka njerëz që punojnë në secilin vend që janë të pasionuar pas temës dhe e promovojnë brenda dhe jashtë. Dhe trajnojmë më shumë se 1000 kolegë në tërë grupin çdo vit. Në fund, e rrisim edhe ekspertizën tonë duke përcaktuar që gjitha bankat e rrjetit duhet të emetojnë obligacionet e tyre të gjelbra kurdo që është e mundur. Fakti që obligacionet e gjelbra janë aq shumë të pranishme në rajonin e EQL-së, sigurisht që i detyrohet rrjetit të bankave tona. Si grup, jemi emetuesi më i madh i obligacioneve të gjelbra në rajon. Dhe nuk duhet harruar se investimi i gjelbër në EQL ka ndikim shumë më të madh se në Evropën Perëndimore, sepse, për shembull, miksi i energjisë është shumë më i varfër.

Përveç potencialit të biznesit dhe ndikimit pozitiv në mjedis, çfarë ju shtyn, cila është e bukura e financave të qëndrueshme?

Veçanërisht më pëlqen ndikimi në njerëz, kolegët e mi. Jo vetëm që fitojnë para për bankën, e që edhe është puna e tyre, por janë në pozitë të mirë të dinë që ajo çfarë bëjnë, produktet që i strukturojnë, njohuritë që i përcjellin tutje japin kontribut pozitiv që është i qëndrueshëm në afat të gjatë dhe në kuptimin e vërtetë të fjalës. I jep kuptim asaj që e bëjnë profesionalisht dhe njerëzit që punojnë në këtë fushë, vërtet e çmojnë këtë. Kjo vlen edhe për mua, sigurisht.



RaiEco: Kredia e gjelbër për transformimin e shtëpisë tuaj

Transformoni me zgjuarsi shtëpinë tuaj me kredinë RaiEco dhe kualifikohuni për një grant që mund të mbulojë deri në 20% të këtij investimi.

Në një epokë ku shqetësimet mjedisore dhe efienca e energjisë po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, konsumatorët po i drejtohen investimeve me eficiencë të energjisë për ta reduktuar konsumin e energjisë elektrike dhe kostot e shërbimeve. Që nga nëntori i vitit 2021, Raiffeisen Bank në Kosovë ka prezantuar kredinë e saj të gjelbër RaiEco, e cila ofron një zgjidhje të shkëlqyer pikërisht për ata që përpiqen t'i përmirësojnë shtëpitë e tyre me pajisje dhe teknologji me eficiencë të energjisë.

Kredia është krijuar për t'u ofruar klientëve financim për një përzgjedhje të gjerë teknologjish dhe produktesh. Për më tepër, ajo u mundëson atyre të përfitojnë deri në 20% të investimit të tyre duke aplikuar për një grant të ofruar nga Fondi i Financimit të Ekonomisë së Gjelbër (GEFF).

[Instrumentat dhe Konsulentët e GEFF ndihmojnë në përmirësimin e vendimeve të financimit të gjelbër dhe praktikave të tregut në 24 shtete – duke mbështetur tranzicionin e tyre drejt ekonomisë së gjelbër.](#)

Cilat investime janë të pranueshme për t'u kualifikuar për RaiEco?

Investimet për izolimin e shtëpive dhe apartamenteve, teknologjitë fotovoltaike, zëvendësimin e dyerve dhe dritareve, pompat e ngrohjes dhe pajisje të tjera kualifikohen për kredi RaiEco.

Vizitoni linkun e mëposhtëm për të mësuar rreth pajisjeve që përmbushin standardet e performancës të vendosura nga BERZH për GEFF në Kosovë.

[Home page \(lebrdgeff.com\)](http://lebrdgeff.com)

Si të aplikoni?

Aplikimi për këtë kredi është i thjeshtë dhe bëhet online duke plotësuar një formular aplikimi.

Informacione të mëtejshme dhe formularin për të aplikuar mund ta gjeni [KËTU](#). E ardhmja fillon tash (raiffeisen-kosovo.com)

Investo në shtëpi dhe fito grant!



JU MUND TË KONTAKTONI BANKËN PËR INFORMACION TË MËTEJSHËM NË LIDHJE ME KREDINË.



Toçi: Synimi ynë është të ndërtojmë një bankë digjitale me prekje njerëzore



Iliriana Toçi, Anëtare e Bordit Menaxhues në Raiffeisen Kosova, diskuton fokusin e bankës në ndërtimin e një banke digjitale me ndërveprim njerëzor, kultivimin e një marrëdhënie afatgjatë me sektorin e biznesit dhe strategjitë për prioritizimin e ofrimit të shpejtë të shërbimeve dhe produkteve.

Sipas jush, çfarë e bën Raiffeisen Bank një bankë miqësore për biznesin?

Banka Raiffeisen njihet rëndësinë e segmentit të NVM-ve në gjenerimin e vlerës dhe rritjes për ekonominë e Kosovës dhe si e tillë vazhdimisht synon ta përmirësojë modelin e shërbimit ndaj këtij grupi të synuar. Të bëhesh një bankë ku kanë llogari NVM-të ofron avantazhe të ndryshme, duke përfshirë rritjen e besnikërisë së klientit, mundësitë e shitjes së tërthortë, menaxhimin efektiv të rrezikut, uljen e kostove të blerjes së klientëve, pozicionimin konkurrues, angazhimin e komunitetit, përfitimet rregullatore dhe rentabilitetin. Kjo qasje përputhet me qëllimin e ndërtimit të marrëdhënieve afatgjata me NVM-të dhe plotësimin e nevojave të tyre të ndryshme financiare. Në këtë kontekst, banka ka mbajtur një angazhim të palëkundur për ta rritur përvojën e klientit gjatë viteve. Ky përkushtim është i dukshëm nëpërmjet një oferte gjithëpërfshirëse të produktit dhe një strategjie efikase të kohës nga krijimi i produktit deri te vendosja në treg. Gjithashtu, qëllimi ynë i vazhdueshëm është të rrisim lehtësinë e ndërveprimeve me klientët me bankën. Ne vlerësojmë progresin tonë në këtë drejtim duke mbledhur në mënyrë aktive informatat kthyese të klientëve përmes mjeteve të ndryshme, qofshin ato digjitale ose me prani fizike.

Njëkohësisht, banka ka kërkuar vazhdimisht që e para të sjellë qasjet inovative të biznesit që përputhen me zhvillimet teknologjike, për shembull me fillimin e zbatimit të Raiconnect - mjet për bashkëpunim nga distanca, RAIPOS - aplikacion për pranimin e pagesave dhe SME On - zgjidhje digjitale për të fituar klientë të ri nëpërmjet internetit. Besojmë fuqimisht se këto zgjidhje u japin klientëve tanë vlerë të prekshme, duke riformësuar perspektivat e tyre dhe duke vendosur standarde të reja për atë që përfaqëson bankimi bashkëkohor. Qasja me klientin në qendër që kemi adoptuar ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në treg, veçanërisht

brenda segmentit mikro. Kjo është e evidente në rritjen e konsiderueshme të portofolit tonë kreditor dhe të depozitave ndër vite. Si rezultat, ne tani kemi një përqindje mbresëlënëse prej 21.2% të tregut në asete dhe jemi të gatshëm për avancim të mëtejshëm. Në të njëjtën kohë, ne kryesojmë në Rezultatin Neto të Promoterit (NPS - Net Promtor Score) me një rezultat të jashtëzakonshëm prej 42 në sondazhin e fundit, duke tejkaluar konkurrentët tanë të drejtpërdrejtë me të paktën 30%. Besojmë se propozimi ynë për vlerën e tregut, me theks në klientin në qendër dhe integrimi i teknologjisë në shërbimet bankare do të vazhdojë ta shtyjë performancën tonë në treg për vitet në vijim.

Cilat nga shërbimet dhe produktet tona financiare mendoni se janë më të rëndësishme për bizneset që operojnë në Kosovë?

Në Kosovë, ku ka përafërsisht 96,000 biznese aktive, me 11,000 sipërmarrje të reja që shfaqen çdo vit, është thelbësore që ta përshtatim qasjen tonë ndaj biznesit për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme dhe gjithnjë në zhvillim të këtij tregu kryesisht të mikro-segmentuar.

Një nga strategjitë tona kryesore sillen rreth prioritizimit të ofrimit të shpejtë të produkteve dhe shërbimeve. Në fushën e mikro-kreditimit na veçon përkushtimi ynë ndaj shpejtësisë. Ne mburremi me 'kohën për miratim' dhe 'kohën për para' mbresëlënëse për kreditë pa kolateral [unsecured loans], me vendime të marra brenda dy ditëve dhe fonde të disbursuara brenda tri ditëve. Kjo veçori rezonon fuqishëm me tregun, duke na vendosur si partnerin e preferuar bankar. Njëkohësisht, ne i kushtojmë rëndësi të madhe bankimit të përditshëm, veçanërisht në sferën digjitale. Përpjekjet tona të vazhdueshme përfshijnë përmirësimin e platformës sonë të bankimit elektronik për biznese, prezantimin e veçorive të reja dhe zgjerimin e opsioneve të pagesave. Ne kemi

inkorporuar gjithashtu konceptin e bankimit nga distanca, duke u kujdesur për klientët që preferojnë zgjidhje digjitale. Së fundi kemi lansuar RAIPOS, një zgjidhje për pranimin e pagesave e cila imiton terminalin fizik POS, por e qasshme përmes telefonave të mençur, duke rritur më tej përvojën bankare për klientët tanë. Besojmë fuqishëm se ndërveprimet me klientët po evoluojnë vazhdimisht dhe qasja jonë ndaj marrëdhënieve duhet të evoluojë së bashku. Angazhimi ynë ndaj shkathtësisë dhe inovacionit na pozicionon si një institucion financiar që mendon paraprakisht për t'i plotësuar nevojat gjithnjë në ndryshim të klientelës sonë të çmuar.

Si e ndërthurni digjitalizimin dhe rrjetin e degëve për të ndikuar në shërbimin ndaj bizneseve?

Qëllimi ynë është të ndërtojmë një bankë digjitale me prekje njerëzore. Besojmë fuqimisht se mbajtja e një rrjeti degësh është thelbësore për realizimin e këtij vizioni. Qasja jonë përqendrohet në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve digjitale më të fundit, duke ruajtur ngrohtësinë e ndërveprimit njerëzor. Në fund të fundit, qëllimi ynë është t'i sigurojmë klientët tanë se pas fasadës digjitale të avancuar, banka jonë mbetet e rrënjësor thellë në vlerat njerëzore.

Mjedisi i NVM-ve në Kosovë paraqet karakteristika unike dhe vjen me sfida të veçanta sa i përket digjitalizimit, veçanërisht për shkak të vonësës ekzistuese në legjisllacionin digjital. Megjithatë, si bankë, ne kemi bërë investime të konsiderueshme në iniciativat tona digjitale me synimin për të ngritur përvojën e klientit dhe për ta pozicionuar veten si pionierë në inovacion.

Një shembull kryesor i angazhimit tonë ndaj këtij transformimi digjital është prezantimi i fundit i SME On Solution. Kjo ofertë novatore mundëson një proces të thjeshtuar dhe shumë efikas të hapjes së llogarisë digjitale. Reagimi i tregut ndaj kësaj risie ka qenë jashtëzakonisht pozitiv, ku 52% të të gjitha hapjeve të llogarive gjatë gjithë vitit u lehtësuan përmes SME On. Për shkak të mungesës së legjisllacionit për nënshkrimin digjital, klientëve u kërkohet aktualisht të vizitojnë degët tona për të nënshkruar fizikisht kontrata. Gjatë këtyre vizitave, stafi ynë i dedikuar i degës i pret me mirëseardhje të ngrohtë dhe i udhëzon me efikasitet klientët gjatë procesit të nënshkrimit, duke adresuar gjithashtu çdo kërkesë tjetër që ata mund të kenë. Ky ndërveprim i prekshëm me klientët ripohon besimin tonë se degët dhe shërbimet digjitale jo vetëm që plotësojnë njëra-tjetrën, por edhe lulëzojnë së bashku.

Çfarë roli luan Raiffeisen në promovimin e praktikave të qëndrueshme për bizneset?

Zhvillimet e fundit në tregun e Kosovës kanë nënvizuar rolin kryesor të sektorit financiar në nxitjen e praktikave të qëndrueshme në mesin e bizneseve. Nëpërmjet partneriteteve strategjike dhe programeve tërheqëse, ne kemi rritur me sukses ndërgjegjësimin brenda komunitetit të biznesit në lidhje me përvetësimin e praktikave dhe investimeve të qëndrueshme që reduktojnë emetimet e gazrave serrë duke promovuar qëllimin miqësor ndaj mjedisit. Këtë vit, ne kemi përfunduar 'Programin

tonë për Mbështetjen e Konkurrueshmërisë së NVM-ve' me një alokim të konsiderueshëm prej 5 milionë eurosh. Gjithashtu, ne jemi duke eksploruar në mënyrë aktive bashkëpunime të reja të natyrës së ngjashme. Këto iniciativa fuqizojnë klientët tanë të bëjnë investime në eficientësi dhe energjisë, kalimin në burimet e ripërtërishme të energjisë dhe t'i nënshtrohen transformimeve digjitale për bizneset e tyre.

Në një dëshmi të përkushtimit tonë të palëkundur për zhvillim të qëndrueshëm, ne festuam 20 vjetorin e bankës në Kosovë përmes një Samiti ESG (Mjedisor, Social dhe të Qeverisjes). I mbajtur më 15-16 qershor në Prishtinë, kjo konferencë paraqiti një seri diskutimesh të përqendruara rreth aspekteve të ndryshme të promovimit të qëndrueshmërisë, zbutjes së ndryshimeve klimatike dhe mobilizimit të burimeve për t'i mbështetur iniciativat e gjelbra. Aktiviteti përfshiu edhe një panair ku bizneset shfaqën aktivitetet e tyre duke kontribuar në agjendën e gjelbër.

Përfaqësuesit pjesëmarrës nga institucionet e Kosovës, bizneset, si dhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare u angazhuan në panel diskutime, duke nxitur një eksplorim të sfidave dhe mundësive në rrugën drejt një ekonomie të qëndrueshme dhe të ndërgjegjshme për mjedisin. Ata gjithashtu njohën angazhimin e palëkundur të Bankës Raiffeisen për të çuar përpara këtë kauzë jetike.

Në një botë në ndryshim të ndikuar shumë nga digjitalizimi, cili është qëndrimi juaj për rolin e njerëzve, strukturave dhe degëve në ofrimin e vlerës për klientët e biznesit?"

Siç u përmend më parë, vizioni ynë është të ndërtojmë një bankë digjitale me një prekje njerëzore. Edhe pse ne jemi të përkushtuar të automatizojmë shërbimet, të thjeshtojmë proceset dhe të ofrojmë zgjidhje digjitale për të gjithë klientët tanë, ne e kuptojmë se elementi njerëzor mbetet thelbësor. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në Kosovë, ku peizazhi digjital është ende duke u përpjekur për ta arritur Evropën Perëndimore.

Në këndvështrimin tim, njerëzit vazhdojnë të jenë pasuria jonë më e vlefshme. Nevojat tona në zhvillim kërkojnë një fokus të vazhdueshëm në edukimin, zhvillimin dhe mbajtjen e punonjësve tanë, veçanërisht pasi ato bëhen gjithnjë e më të pakta për shkak të faktorëve të tillë si ikja e rrurit. Për të adresuar këtë sfidë, ne po dyfishojmë përpjekjet tona dhe po zbatojmë në mënyrë aktive praktikatat më të mira për të mbajtur fuqinë tonë punëtore të motivuar dhe të angazhuar.

Në degët tona, ne kemi prezantuar nismën 'Branches Going Agile'. Kjo nismë fuqizon stafin tonë për të marrë më shumë vendime në mënyrë të pavarur, duke shfrytëzuar potencialin e tyre të plotë. Kam besim të plotë se investimet tona të vazhdueshme në njerëzit tanë, të kombinuara me agjendën tonë digjitale, do të na mundësojnë me të vërtetë të krijojmë një 'bankë digjitale me prekje njerëzore'.



Zvogëlimi i gjurmës së karbonit përmes praktikave tona eko-miqësore

Banka Raiffeisen në Kosovë është e përkushtuar që të kultivojë bankimin e përgjegjshëm për një të ardhme më të qëndrueshme, duke zbatuar praktika miqësore me ambientin. Sa i përket qëndrueshmërisë së brendshme, banka e njih rëndësinë e adresimit të ndikimit të aktiviteteve të veta në mjedis.

Në këtë drejtim, banka ka filluar shpërndarjen e kartelave të reja të debitit dhe kreditit VISA nga materiali i ricikluar për klientët e saj. Përdorimi i këtyre kartelave do të ndihmojë në mbrojtjen e mjedisit duke ulur gjurmën e karbonit, zvogëluar sasinë e mbeturinave në deponi, shmangien e ndotjes së ujit/ ajrit, zvogëlimin e konsumit të energjisë (që përdoret për prodhimin e kartelave të zakonshme).

Gjithashtu, gjatë viteve të fundit, banka ka zbatuar masa të ndryshme qëndrueshmërie. Për shembull, flota jonë e transportit përbëhet nga 35 automjete hibride dhe ne planifikojmë ta zëvendësojmë më tej flotën tonë me automjete hibride.

Po ashtu kemi përditësuar politikën tonë të udhëtimit për biznes me fokus në reduktimin e gjurmës sonë të karbonit, duke demonstruar përkushtimin për mbrojtjen e mjedisit dhe klimës. Për të gjeneruar energji të pastër, ne kemi instaluar panele diellore për të siguruar energji elektrike për përdorim të brendshëm. Në vitin 2022, këto panele prodhonin deri në 38,000 kWh ose 38 MWh energji diellore. Banka ka ulur gjithashtu konsumin e letrës dhe tani përdor letër 100% të riciklueshme.

Gjithashtu, ne kemi filluar aplikimin e një sistemi të menaxhimit të mbeturinave brenda kompanisë që përfshin kosha të veçantë për riciklimin e mbeturinave brenda ndërtesave dhe në bashkëpunim me kompanitë e autorizuara të riciklimit. Ne, gjithashtu, jemi të përkushtuar në rritjen e gjelbërimit brenda dhe jashtë ambienteve tona përmes iniciativave të vazhdueshme të mbjelljeve.



Galeria Raiffeisen: Promovimi i artit lokal që nga viti 2016

Me siguri keni pasur rastin që të magjepseni me vepra arti në Albi Mall në Prishtinë, një nga qendrat më të vizituara tregtare në Kosovë.

Që nga viti 2016, Galeria Raiffeisen, e mbështetur bujarisht na banka jonë, ka qenë një platformë për artistët vendas që të shfaqin talentin e tyre.

Ky projekt, i cili përfundon në fund të këtij viti, i ka ofruar secilit artist një qëndrim një-mujor në një nga zonat më të frekuentuara të qendrës Albi, duke shërbyer si një hapësire unike për të shfaqur krijimtarinë e tyre.

➤ Vizitoni ekspozitën dhe blini pikturën tuaj të preferuar! ➤

Krijimi i një kulture të suksesshme në vendin e punës

Banka jonë është e përkushtuar për të nxitur një kulturë të suksesshme në vendin e punës të fokusuar në mësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional. Puna e vazhdueshme në këtë fushë, e kryer nga Departamenti i Njerëzve, Kulturës dhe Mësimin, e ka bërë Bankën Raiffeisen një punëdhënëse të dëshirueshëm në Kosovë.

Departamenti kërkon në mënyrë aktive mënyra për ta përmirësuar mjedisin e punës dhe lista e përfitimeve të punës me Raiffeisen është rritur vazhdimisht gjatë viteve. Organizata jonë ka një qëllim të qartë: të jetë një Punëdhënëse i Dëshirueshëm në Kosovë dhe të hartimi i propozimit të përshtatshëm për vlerën e punonjësve që do t'i tërhiqte dhe ruante talentët e dalluar është një objektivi strategjik kryesorë në agjendë.



Mësimi i vazhdueshëm

Banka ofron një larmi mundësish arsimore përmes disa platformave, duke përfshirë sistemin e sapopërmirësuar të Menaxhimit të të Mësuarit Online (LMS). Ofrohen gjithashtu mundësi të tjera trajnimi në terren, siç është Festivali i Mësimin [Learning Festival], i cili mbajti edicionin e tij të katërt në shtator të këtij viti. Prezantimet, diskutimet në panel, punëtoritë dhe aktivitetet e tjera të të mësuarit dhe zhvillimit të aftësive, të fokusuar kryesisht në tema që lidhen me biznesin dhe teknologjinë, ishin pjesë e programit të këtij viti. Festivali promovon mësimin si një nga vlerat thelbësore brenda bankës. Siç deklaroi Drejtoresha Ekzekutive, znj. Anita Kovacic, në hapjen e festivalit, rëndësia e mësimin është e njëjtë si për ata që sapo kanë filluar karrierën e tyre ashtu edhe për të tjerët që duhet të vazhdojnë të mësojnë për të pasur informacione të përditësuara lidhur me zhvillimet dhe trendet më të fundit.

Promovimi i ekuilibrit punë-jetë

Banka jonë vlerëson fleksibilitetin, duke kuptuar se sa i rëndësishëm është ekuilibri punë-jetë. Punonjësit kanë orar fleksibil të punës, duke u mundësuar atyre t'i ekuilibrojnë më mirë detyrimet e tyre personale dhe profesionale. Modeli hibrid i punës është miratuar gjithashtu nga banka, duke kombinuar punën nga distanca dhe praninë fizike për të siguruar një bilanc që plotëson preferencat dhe nevojat individuale.

Përfitimet

Banka jonë ofron një gamë të gjerë përfitimesh shtesë që kontribuojnë në mirëqenien e punonjësve, duke përfshirë një restorant të përbalueshëm në zyrat e saj kryesore në Prishtinë, si dhe qasje në hapësira sportive, duke promovuar aftësinë fizike dhe një mënyrë jetese të shëndetshme në mesin e punonjësve. Lista e gjatë e përfitimeve përfshin norma interesi preferenciale, paga konkurruese, sigurime shëndetësore, ekskursionet dhe shumë më tepër.

Zbuloni mundësitë tona të karrierës

Raiffeisen Bank në Kosovë vazhdimisht po punëson njerëz të rinj. Edhe pse publikojmë thirrjet e hapura edhe në kanalet kryesore të rrjeteve sociale të bankës, ju mund ta ndiqni faqen tonë në LinkedIn Career @Raiffeisen Bank Kosovo për thirrjet.

Na vizitoni!

Banka synon të organizojë më 22 nëntor një ngjarje të Ditës së Hapur (Open Day) për të lejuar publikun të shohë nga afër një ditë të zakonshme pune në bankën tonë. Na ndiqni për të kuptuar rreth datës së kësaj ngjarje.

